



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 111-21663/22

Datë: 24.06.2022

Mbështetur në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, në Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, në Ligjin për arsimin dhe aftësimin profesional nr. 04/L-138 si dhe në UA nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve në klasë dhe raportin mësimdhënës-nxënës, Drejtoria e Arsimit shpall:

K O N K U R S

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLA TË MESME TË LARTA- NË GJIMNAZIN " LUIGJ GURAKUQI" DHE NË SHMP " FEHMI AGANI " NË KLINË PËR VITIN SHKOLLOR 2022/2023

Konkursi shpallet me këto kushte dhe kriteret:

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale për vitin shkollor 2022/23 mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9 të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftësive në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Certifikatën e lindjes.

Numri i nxënësve që do të pranohen në dy shkollat e mesme të larta në Klinë

Gjimnazi "Luigj Gurakuqi" Klinë

Nr.	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nxënës në një paralele	Gjithsej nxënës
1	Drejtimi shoqëroro-gjuhësor	5	32	160
2	Drejtimi shkenca natyrore	5	32	160
	Gjithsej	10	32	320

SHMP "Fehmi Agani" Klinë

Fusha	Profili	Nr. i paral..	Nr. i nx.	Vitet e shkollimit
Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Operator prodhimi	2	48	2+1
	Trafik rrugor	1	24	2+1
	Automekanik	1	24	2+1
	Gjeolog	1	24	2+1
	Xehetar	1	24	2+1
	Mekatronikë	1	24	2+1
	Saldator	1	24	2+1
	Ndërtimtari	1	24	2+1
	Instalues elektrik	1	24	2+1
	Instalues i ngrohjes e klimatizimit dhe ujësjellësit	1	24	2+1
Shëndeti dhe mirëqenia	Bashkëpunëtor profesional i infermierisë	1	24	2+1
Ekonomi, administrim dhe juridik	Kontabilist dhe tatime	1	24	2+1
Agrokulturë, pylltari, peshkatori dhe veterinari	Perponues i ushqimit dhe profesione te ngjashme	1	24	2+1
Teknologjia e informacionit dhe komunikimit	Informatikë	1	24	2+1
	Gjithsej	15	360	

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2022/2023, bëhet më datën **27, 28 dhe 29 qershor 2022** në lokalet e shkollës amë ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **8.00-16.00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **30.6.2022**.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej **1.7.2022**.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar ka të drejtë ankese brenda dy ditësh pune nga koha e shpalljeve të rezultateve. Ankesat parashtrihen në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkallën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda dy ditësh pune pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | |
|---|---------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100%) 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë minimum 4.00 (së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat 6-9, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm nga shkollimi i obligueshëm (klasa 6,7, 8, 9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

Suksesi (klasa 6 + klasa 7 + klasa 8 + klasa 9) x 2 = 40 pikë max.

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë:
Mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III) + mesatarja e lëndës (IV) = 20 pikë max.

- Lëndët me prioritet në sukses sipas drejtimeve të gjimnazeve:

- a. Gjimnazi i shkencave natyrore: Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë
- b. Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore: Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Histori, Gjeografi

- Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAAP:

- a. Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji Ushqimore dhe Veterinari:

Biologji, Kimi, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi.

- b. Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi-Teknologji, PTT, Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë:

Matematikë, Informatikë, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi.

- c. Juridik dhe administratë:

Edukatë qytetare, Histori, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjeografi

- d. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm:

Edukatë qytetare, Histori, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjeografi

- e. Shkollat artistike:

Gjuhë amtare dhe letërsi, Edukatë qytetare, Art, Muzikë

Drejtimi pedagogjik-profil bashkëpunëtor muzikor:

Nxënësi duhet të ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. 9) dhe testin kombëtar.

Drejtimi instrumental:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl.9) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VII); në klasën VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI)

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e 10-të duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

4. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare sipas drejtimeve përkatëse:

- **Gjimnazi i shkencave natyrore-** Mesatarja e lëndëve; fizikë, kimi, biologji dhe matematikë duhet të jetë së paku 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët: fizikë, kimi dhe biologji.

$$\frac{\text{Mes (kimi)} + \text{mes (biologji)} + \text{mes (fizikë)} + \text{mes (matematikë)}}{4} \geq 4$$

4

- **Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore-** Mesatarja e lëndëve: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve

nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët histori, gjeografi dhe edukatë qytetare)

$$\frac{\text{Mes (gjuhë shqipe) + mes (gjuhë angleze) + mes (histori) + mes (gjeografi)}}{4} \geq 4$$

- **Shkollat e shëndetësisë-** Mesatarja e lëndëve: kimi, biologji, fizikë dhe gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji)

$$\frac{\text{Mes (kimi) + mes (biologji) + mes (fizikë) + mes (gjuhë shqipe)}}{4} \geq 4$$

B. Përmbajtja e testit- numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve

I. Gjuhë

1. Gjuhë shqipe 35 pikë
2. Gjuhë angleze 15 pikë (gjithsej 50 pikë)

II. Shkencat shoqërore

1. Gjeografi 25 pikë
2. Histori 25 pikë (gjithsej 50 pikë)

III. Matematikë

1. Matematikë 35 pikë
2. Informatikë 15 pikë (gjithsej 50 pikë)

IV. Shkencat natyrore

1. Fizikë 17 pikë
2. Kimi 16 pikë
3. Biologji 17 pikë (gjithsej 50 pikë)

5. Kriteret e lëndëve me prioritet në test sipas drejtimeve të gjimnazeve:

1. Gjimnazi shkencat e natyrës:

1. Shkencat e natyrës 50 $50 \times 0.4 = 20$ pikë
2. Matematikë dhe Informatikë 50 $50 \times 0.2 = 10$ pikë
3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 50 $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë
4. Shkencat shoqërore 50 $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë
(gjithsej 40 pikë)

2. Gjimnazi shoqëror dhe gjuhësor:

1. Shkenca shoqërore 50 $50 \times 0.4 = 20$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 50 $50 \times 0.2 = 10$ pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 50 $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë
4. Shkenca natyrore 50 $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë
(gjithsej 40 pikë)

6 Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në IAAP

I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

1. Shkencat natyrore 25 $50 \times 0.4 = 20$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $50 \times 0.2 = 10$ pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 25 $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë
4. Shkencat shoqërore 25 $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë
(gjithsej 40 pikë)

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi – Teknologji

1. Matematikë dhe Informatikë 25 $50 \times 0.4 = 20$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $50 \times 0.2 = 10$ pikë
3. Shkenca natyrore 25 $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë
4. Shkenca shoqërore 25 $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë
(gjithsej 40 pikë)

III. Ekonomi

1. Matematikë dhe Informatikë 25 $50 \times 0.4 = 20$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $50 \times 0.2 = 10$ pikë
3. Shkenca natyrore 25 $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë
4. Shkenca shoqërore 25 $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë
(gjithsej 40 pikë)

IV. Juridik

1. Shkencat shoqërore 25 $50 \times 0.4 = 20$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $50 \times 0.2 = 10$ pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 25 $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë
4. Shkenca natyrore 25 $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë
(gjithsej 40 pikë)

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $50 \times 0.4 = 20$ pikë
2. Shkenca shoqërore 25 $50 \times 0.2 = 10$ pikë
3. Matematikë dhe Informatikë 25 $50 \times 0.15 = 7.5$ pikë
4. Shkenca natyrore 25 $50 \times 0.05 = 2.5$ pikë
(gjithsej 40 pikë)

VI. Shkollat Artistike

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze	25	50 x 0.4 = 20 pikë
2. Shkenca shoqërore	25	50 x 0.2 = 10 pikë
3. Matematikë dhe Informatikë	25	50 x 0.15 = 7.5 pikë
4. Shkenca natyrore	25	50 x 0.05 = 2.5 pikë
		(gjithsej 40 pikë)

VII. Kriteret specifike për regjistrimin në shkolla të muzikës

a. Drejtimi pedagogjik – profili bashkëpunëtor muzikor:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar;

b. Drejtimi instrumental:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VII);

c. Në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI).

e. Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës

DREJTORI I DKA-së
Dr.sc. Qemajl Sejdiu

